



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Memorandum Bashkëpunimi

në mes të

Youth Initiative for Human Rights – Kosovë (YIHR – KS)

dhe

Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK)

Lidhur me themelimin e një bashkëpunimi më të ngushtë midis institucioneve të drejtësisë dhe shoqërisë civile, specifikiisht bashkëpunimin e Youth Initiative for Human Rights – Kosovë (në vazhdim YIHR KS) me Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në vazhdim si KGJK) në kuadër të projektit “Të Rinjtë për Drejtësi”;

Duke pasur parasysh qëllimin e YIHR KS që të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe transparencës së sistemit të drejtësisë ;

Duke pasur parasysh qëllimin e KGJK për të zhvilluar shkathhtësitë profesionale praktike të studentëve të Juridikut dhe të ju ofrojë atyre mundësinë të kontribuojnë në gjykatat e Kosovës dhe komunitet, gjithashtu edhe të promovojë punën e tyre në shoqëri;

Duke pasur parasysh qëllimet e YIHR KS dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, palët pajtohen si në vijim:

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është të lehtësojë bashkëpunimin në mes të YIHR KS, KGJK dhe Gjykatave në Kosovë në kuadër të projektit “Të Rinjtë për Drejtësi, që për qëllim ka të fuqizojë të rinjtë të kërkojnë drejtësi dhe të bëhen pjesëmarrës aktivë në sektorin e drejtësisë në Kosovë.

2. Përgjegjësitë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Në frymën e bashkëpunimit drejt arritjes së qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, KGJK, pajtohet të përmbushë përgjegjësitë individuale të mëposhtme:

- a. KGJK u mundëson studentëve të nivelit Bachelor dhe nivelit Master të juridikut dhe të diplomuarve të mbajnë punë praktike në Gjykatat Themelore në Kosovë dhe degët e tyre.
- b. Gjykatat Themelore në Kosovë dhe degët e tyre ofrojnë asistencë për YIHR KS në mbajtjen e eventeve “Ditë e Hapur në Gjykatë”.
- c. Gjykatat Themelore në Kosovë ofrojnë mbështetje përgjatë implementimit të projektit, duke marrë pjesë në debate e diskutime të ndryshme me të rinj të organizuara nga YIHR KS.
- d. Gjykatat Themelore gjithashtu do të mundësojë që studentët dhe të diplomuarit e përzgjedhur nga YIHR KS të monitorojnë seanca gjyqësore.

3. Përgjegjësitë e Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS)

Në frymën e bashkëpunimit drejt arritjes së qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, YIHR KS, pajtohet të përmbushë përgjegjësitë individuale të mëposhtme:

- a. YIHR KS do të përzgjedh dhe koordinojë të gjithë studentët/et dhe të diplomuarit/at për të kryer praktikën nëpër Gjykatat Themelore në Kosovë dhe degët e tyre, duke i kompensuar në shumë prej 200\$ për periudhën 6 mujore.
- b. YIHR KS do organizojë dhe koordinojë eventin “Ditët e Hapura në Gjykatë” në bashkëpunim dhe komunikim me Gjykatat Themelore në Kosovë dhe degët e tyre.
- c. YIHR KS do të organizojë monitorim të seancave gjyqësore përgjatë projektit në koordinim me Gjykatat Themelore.

4. Kohëzgjatja e Memorandumit

Ndryshimet dhe modifikimet mund të bëhen vetëm pas kërkesës me shkrim nga cilado palë dhe mund të hyjnë në fuqi vetëm pas konsultimeve dhe marrëveshjes nga të dy palët. Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndërpritet në mënyrë të menjëhershme nga cilado palë me pëlqim të përbashkët, ose gjashtë muaj pas njoftimit me shkrim dërguar palës tjetër. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

5. Kopjet e Memorandumit të Bashkëpunimit

Ky Memorandum Bashkëpunimi është përgatitur në dy kopje identike, nga një (1) për secilën palë nënshkruese të këtij dokumenti. Ky memorandum është përgatitur në gjuhën shqipe.

Znj. Marigona Shabiu
Drejtore Ekzekutive
Youth Initiative for Human Rights - YIHR KS




Data: 17/11/2021

Z. Albert Zogaj
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës




Data: 17.11.2021